



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2023-10

Prokurori kundër Sabit Januzit dhe Ismet Bahtijarit

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 9 tetor 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Parë mbi Ecurinë e Çështjes dhe
për Parashtrime**

**Ushtruesit të Detyrës së
Zëvendësprokurorit
Vard Ferdinandse**

**Mbrojtësit kujdestar të Sabit Januzit
Tomas Gilis**

**Mbrojtësit kujdestar të Ismet Bahtijarit
Hendrik Sitema**

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të nenit 39(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), dhe rregullën 96(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”) lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 2 tetor 2023, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën kundër Sabit Januzit (“z. Januzi”) dhe Ismet Bahtijarit (“z. Bahtijari”, bashkërisht “të akuzuarit”).² Më të njëjtën ditë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi gjithashtu fletarrestimet për të akuzuarit dhe urdhëroi transferimin e tyre në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë, Holandë (“Vendimi për Arrestim dhe Transferim”).³

2. Më 4 tetor 2023, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dorëzoi Aktakuzën e Konfirmuar.⁴

3. Më 5 tetor 2023, të akuzuarit u arrestuan në Kosovë.⁵ Të nesërmen, të akuzuarit u transferuan në objektin e paraburgimit të DHS-së në Hagë, Holandë,⁶ në

¹ KSC-BC-2023-10, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 11 shtator 2023, publik.

² KSC-BC-2023-10, F00008, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës* (“Vendimi i Konfirmimit”), 2 tetor 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

³ KSC-BC-2023-10, F00009, *Vendim mbi Kërkesën për Fletarrestime dhe Urdhra për Transferim*, 2 tetor 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-4, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* (“Vendimi për Arrestim dhe Transferim”).

⁴ KSC-BC-2023-10, F00010/A01, Prokurori i Specializuar, *Aktakuza*, 4 tetor 2023, rreptësisht konfidencial. Versioni i redaktuar publik i aktakuzës së konfirmuar u dorëzua më 6 tetor 2023, F00016/A01.

⁵ KSC-BC-2023-10, F00011, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Ismet Bahtijarit sipas Rregullës 55(4)*, 5 tetor 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; F00012, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Sabit Januzit sipas Rregullës 55(4)*, 5 tetor 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

⁶ KSC-BC-2023-10, F00014, Administratorja, *Njoftim i Pranimi të Ismet Bahtijarit në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 6 tetor 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; F00015, Administratorja, *Njoftim i Pranimi të Sabit Januzit në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 6 tetor 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

përputhje me Vendimin për Arrestim dhe Transferim të Gjykatësit të Procedurës Paraprake.

4. Më 6 tetor 2023, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi vendimin për mbajtjen e paraqitjeve të para të të akuzuarve më 9 tetor 2023.⁷ Në vendimin në fjalë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake informoi palët gjithashtu se synonte të mbante konferencën e parë mbi ecurinë e çështjes më 12 tetor 2023, në orën 14:00.⁸

5. Më 7 tetor 2023, në pritje të caktimit ose emërimit të Mbrojtësit, Administratorja caktoi Tomas Gilisin si Mbrojtës të z. Januzi⁹ dhe Hendrik Sitemën si Mbrojtës të z. Bahtijari¹⁰, në përputhje me pjesën 17(2) të Udhëzuesit të Punës për Mbrojtësit dhe rregullën 21 të Rregullores për Ndihmë Juridike.

6. Më 8 tetor 2023, të akuzuarit u takuan personalisht me Mbrojtësit e caktuar të tyre në objektin e paraburgimit të DHS-së.¹¹

7. Më 9 tetor 2023, u mbajtën paraqitjet e para të z. Januzi¹² dhe z. Bahtijari¹³. Gjatë seancave, Mbrojtjet e dy të akuzuarve treguan se ishin në dispozicion për konferencën e parë mbi ecurinë e çështjes, për t'u mbajtur të enjten, 12 tetor, në orën 14:00.

⁷ KSC-BC-2023-10, F00017, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Caktimin e Datës së Paraqitjes së Parë të Sabit Januzit dhe Ismet Bahtijarit* ("Vendimi për Paraqitjet e Para"), 6 tetor 2023, publik.

⁸ Vendimi për Paraqitjet e Para, para. 19, 21(f).

⁹ KSC-BC-2023-10, F00018, Administratorja, *Njoftim i Caktimit të Mbrojtësit Kujdestar për Sabit Januzin*, 7 tetor 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

¹⁰ KSC-BC-2023-10, F00019, Administratorja, *Njoftim i Caktimit të Mbrojtësit Kujdestar për Ismet Bahtijarin*, 7 tetor 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcën 1, konfidenciale.

¹¹ KSC-BC-2023-10, F00020, *Raport për Arrestimin dhe Transferimin e Sabit Januzit në Objektin e Paraburgimit*, 9 tetor 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 43, me Shtojcat 1-3, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; F00021, *Raport për Arrestimin dhe Transferimin e Ismet Bahtijarit në Objektin e Paraburgimit*, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para 46, me Shtojcat 1-3, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

¹² Vendimi për Paraqitjet e Para, para. 21(b).

¹³ Vendimi për Paraqitjet e Para, para. 21(a).

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

A. KONFERENCA MBI ECURINË E ÇËSHTJES

8. Në përputhje me rregullën 96(1) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbledh konferencën mbi ecurinë e çështjes gjyqësore sa më shpejt që të jetë e mundshme pas paraqitjes së parë të të akuzuarit, ndër të tjera, për: (i) organizimin e shkëmbimeve midis palëve dhe, kur është e zbatueshme, Mbrojtësit të Viktimave, për të mundësuar përgatitje të shpejtë për gjykim; dhe (ii) ndërmarrjen e hapave që mundësojnë përgatitjet e nevojshme prej palëve në mënyrë të zellshme dhe në kohë.

B. NXJERRJA E MATERIALIT

9. Në pajtim me nenin 21(6) të Ligjit, i gjithë materiali dhe provat ose faktet relevante në zotërim të ZPS-së të cilat janë në favor ose kundër të akuzuarit, i vihen në dispozicion të akuzuarit para fillimit të procesit dhe gjatë procesit, vetëm me kufizimet rreptësisht të domosdoshme dhe me zbatimin e masave mbrojtëse kompensuese të nevojshme. Në pajtim me rregullën 102(3) të Rregullores, ZPS-ja i jep njoftim të hollësishëm Mbrojtjes për çdo material dhe provë që ka në zotërim.

10. Në përputhje me rregullën 102(1)(a) të Rregullores, dhe në varësi të dispozitave të rregullave 105, 106, 107 dhe 108 të Rregullores, ZPS-ja i vë në dispozicion Mbrojtjes dhe, kur është e zbatueshme, Mbrojtësit të Viktimave, materialet mbështetëse të Aktakuzës së Konfirmuar, si dhe të gjitha deklaratat e marra prej të akuzuarit, sa më shpejt që të jetë e mundshme, por të paktën brenda tridhjetë (30) ditësh nga paraqitja e parë e të akuzuarit.

11. Në pajtim me rregullën 102(1)(b) të Rregullores, brenda afatit të përcaktuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe jo më vonë se 30 ditë para hapjes së çështjes nga Prokurorja e Specializuar, ZPS-ja vë në dispozicion të Mbrojtjes materialin në vijim: (i) deklaratat e të gjithë dëshmitarëve të cilët ZPS-ja synon t'i thërrasë si dëshmitarë

në gjykim, në gjuhën që i akuzuari e kupton dhe flet; (ii) të gjitha deklaratat e tjera të dëshmitarëve, aktekspertizat, deponimet ose transkriptet të cilat ZPS-ja synon t'i paraqesë në gjykim; dhe (iii) provat materiale që ZPS-ja synon t'i paraqesë në gjykim.

12. Në pajtim me rregullën 102(2) dhe (4) të Rregullores, çdo deklaratë e dëshmitarëve shitesë të ZPS-së, që nuk është nxjerrë brenda afatit 30-ditësh para hapjes së çështjes nga Prokurori i Specializuar dhe të cilët ZPS-ja synon t'i thërrasë për të dëshmuar në gjykim, i vihet në dispozicion Mbrojtjes, në gjuhën të cilën i akuzuari e kupton dhe flet, sa më shpejt që të jetë e mundur me bashku me arsyet për vonesën në nxjerrjen e tyre. Kjo nxjerrje e informacioneve finalizohet gjatë fazës së procedurës paraprake.

13. Në pajtim me rregullën 102 (3) të Rregullores, ZPS-ja vë në dispozicion çfarëdo deklarate, dokumenti, fotografie dhe lejon këqyrjen e çdo sendi tjetër të prekshëm nën ruajtjen ose kontrollin e Prokurorit të Specializuar, që Mbrojtja i konsideron juridikisht thelbësore për përgatitjen e vet, ose që i janë marrë, apo i përkisnin të akuzuarit.

14. Në pajtim me rregullën 103 të Rregullores dhe në varësi të rregullave 107 dhe 108 të Rregullores, ZPS-ja i vë menjëherë në dispozicion Mbrojtjes çdo informacion për të cilin ka arsye të besohet se sugjeron pafajësinë, apo lehtëson fajësinë e të akuzuarit, apo ndikon në besueshmërinë ose mbështetshmërinë e provave të ZPS-së, sapo një informacion i tillë të jetë nën ruajtjen, kontrollin apo dijeninë faktike të ZPS-së.

15. Në pajtim me rregullën 107(2) të Rregullores, ZPS-ja i bën kërkesë Trupit Gjykses për t'u liruar tërësisht ose pjesërisht nga detyrimi sipas rregullave 102 dhe 103 të Rregullores për nxjerrjen e materialit fillestar nëse informacioni, të cilin e ka nën ruajtje ose kontroll, i është dhënë në mënyrë konfidenciale dhe vetëm për qëllimin e mbledhjes së provave të reja dhe për të cilin nuk ka marrë pëlqimin e dhënësit të informacionit për ta nxjerrë.

C. REDAKTIMET

16. Në pajtim me nenin 23(1) të Ligjit dhe rregullën 80(1) të Rregullores, një Trup Gjykues mund të urdhërojë masa të duhura mbrojtëse për mbrojtjen, sigurinë, mirëqenien fizike dhe mendore, dinjitetin dhe privatësinë e dëshmitarëve, viktimave pjesëmarrëse në procese gjyqësore, si dhe personave të tjerë të rrezikuar për shkak të dëshmisë së dhënë nga dëshmitarët.

17. Në pajtim me rregullën 80(4)(a)(i)-(iii) dhe (d) të Rregullores, këto masa mund të përfshijnë redaktimin e emrave dhe informacioneve të tjera identifikuese në mënyrë që të parandalohet nxjerrja e tyre për të akuzuarin dhe/ose publikun, ku është e nevojshme, e identitetit të dëshmitarit dhe/ose vendndodhjes së dëshmitarit, e viktimës pjesëmarrëse në procese gjyqësore ose të një personi që është i afërm i tyre ose i lidhur me ta.

18. Në pajtim me rregullën 108(1) të Rregullores, ZPS-ja mund t'i bëjë kërkesë Trupit Gjykues, konfidencialisht dhe ex parte, për mosnxjerrjen e informacionit në tërësi ose pjesërisht, atëherë kur nxjerrja e një informacioni të tillë, mund të dëmtojë, ndër të tjera, hetime në kryerje e sipër ose hetime të ardhshme. Në pajtim me rregullën 108(6) të Rregullores, e njëjta gjë vlen *mutatis mutandis* për Mbrojtjen.

III. DISKUTIM

19. Duke pasur parasysh paraqitjet e para të të akuzuarve, procesi i nxjerrjes së provave dhe materialit nga ZPS-ja për Mbrojtjen pritet të fillojë pa vonesë, në pajtim me kornizën ligjore të lartpërmendur dhe në mënyrën dhe afatin që do të përcaktohet nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake. Duke qenë i vetëdijshëm për kuadrin e akuzave, përfshirë bazën e pretendimeve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon të miratojë një ritëm të shpejtë me qëllim përfundimin e fazës paraprake në kohë. Për të lehtësuar këtë proces të nxjerrjes së materialit në të mirë të palëve, veçanërisht Mbrojtjes, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbledh konferencën mbi ecurinë e

çështjes, sikurse përcakton rregulla 96(1) e Rregullores, për të marrë parashtime lidhur me: (i) materialet e renditura në shtojcën e këtij urdhri; (ii) sistemin e redaktimit të miratuar për këtë proces gjyqësor, siç shtjellohet më tej paragrafin 21, më poshtë; dhe (iii) çdo temë tjetër relevante që nuk është përfshirë në materialet e renditura të bashkëngjitura, e që palët e gjykojnë të nevojshme. Pasi ka shqyrtuar parashtimet e Mbrojtjes gjatë paraqitjeve të para, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vendos të mbajë konferencën mbi ecurinë e çështjes të enjten, 12 tetor 2023.

20. Gjithashtu, palët ftohen që, nëse dëshirojnë, të dorëzojnë parashtime me shkrim, lidhur me cilindo nga materialet e renditura në Shtojcën e këtij urdhri ose me ndonjë temë tjetër relevante që ata e gjykojnë të nevojshme. Në rast se informacioni nuk mund të shkëmbehet me palën tjetër për arsye konfidencialiteti dhe mbrojtjeje, parashtimet mund të dorëzohen me shkrim *ex parte*. Informacionet e ofruara nga palët do ta ndihmojnë Gjykatësin e Procedurës Paraprake në përpilimin e vendimit kornizë mbi nxjerrjen e provave dhe çështjeve lidhur me to, përfshirë afatin për nxjerrje të materialit.

21. Gjykatësi i Procedurës Paraprake, e gjykon po ashtu të nevojshme të kërkojë dhënien e mendimeve me shkrim nga palët në lidhje me sistemin e redaktimit të informacionit dhe të provave që do të zbatohet në këtë çështje gjyqësore sipas asaj që përcaktohet në Vendimin Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje Përkatëse, në çështjen gjyqësore KSC-BC-2020-04, i cili u zbatua gjatë fazës paraprake në mënyrë përrputhëse në katër procese të ndryshme.¹⁴ Këto mendime do të shërbejnë si informacion për Gjykatësin e Procedurës Paraprake për t'u bazuar gjatë miratimit të sistemit të redaktimit, që do të mundësojë efikasitetin e procesit të nxjerrjes së

¹⁴ KSC-BC-2020-04, F00033, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje të Lidhura me Të*, 30 prill 2021, publik, para. 75-91; KSC-2020-07, F00104, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje lidhur me Të*, 22 janar 2021, publik, para. 68-84; *Shih gjithashtu*, KSC-BC-2020-06, F00099, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje Lidhur me Të*, 23 nëntor 2020, publik, para. 82-98; KSC-BC-2020-05, F00034, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim kornizë mbi nxjerrjen e provave dhe çështje përkatëse*, 9 tetor 2020, publik, para. 73-89.

materialit duke balancuar detyrimin për të mbrojtur interesat e viktimave dhe dëshmitarëve me respektimin e të drejtave të të akuzuarve sipas nenit 21 të Ligjit.

22. Gjithashtu, duke pasur parasysh se të akuzuarit akuzohen për tri vepra të ndryshme penale, që përfshijnë pesë forma të përgjegjësisë, nxjerrja e provave duhet të vazhdojë në mënyrë të organizuar dhe efikase, duke shfrytëzuar plotësisht sistemin elektronik në dispozicion për nxjerrje të materialit.¹⁵ Procesi i organizuar i nxjerrjes së materialit do t'i mundësojë Mbrojtjes që të përgatitet mjaftueshëm dhe shpejtë për proceset e ardhshme, rrit produktivitetin dhe efikasitetin e procesit, dhe përfundimisht do t'i mundësojë Trupit Gjykses që të marrë provat materiale me rregull. Kjo në veçanti vlenë për këtë çështje, ku procedurat paraprake duhet të përfundohen brenda kohës së caktuar. Për këtë qëllim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e gjykon të nevojshme të kërkojë dhënien e mendimeve nga palët nëse: (i) ZPS-ja, gjatë nxjerrjes së paketave të materialit mbështetës sipas rregullës 102(1)(a) dhe të provave sipas rregullës 102(1)(b); dhe (ii) Mbrojtja, gjatë nxjerrjes së paketave të materialit, nëse ka, që përfshihet në rregullën 104(1), (5), dhe (6) të Rregullores, mund të miratojë në *Legal Workflow* nënkategorizim për këtë çështje gjyqësore, përfshirë informacionin në vijim: (i) veprat penale bazë: “pika 1”, “pika 2”, “pika 3”, “të gjitha”; (ii) sjelljen e pretenduara të akuzuarve: “kryerje”, “bashkëkryerje”, “marrëveshje për të kryer vepra penale”, “ndihmë”, “tentativë”, “të gjitha”; dhe (iii) të akuzuarit: “Januzi”, “Bahtijari”, “të gjithë”.¹⁶ Palët ftohen gjithashtu të propozojnë nënkategori të tjera të cilat mund të shtohen, nëse e gjykojnë të nevojshme.

23. Kujtojmë se, megjithëse të akuzuarit kanë të drejtën të jenë të pranishëm fizikisht në pajtim me rregullën 96(2) të rregullores, duke marrë parasysh natyrën teknike të

¹⁵ Shih rregullën 109(a) të Rregullores; Njësia për Administrimin e Gjykatës, *Udhëzues për Përdoruesin e Legal Workflow të Dhomave të Specializuara*, 15 prill 2021, *limité*, i cili gjendet në <<https://kosmos.scp-ks.org/JSD/CMU/Documents/20210415-KSCLW-UserGuide-v1.1-LIMITE.pdf>>.

¹⁶ Shih ngjashëm, KSC-BC-2020-06, F00218, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Kategorizimin e Provave sipas Rregullës 109(c) dhe Çështje të lidhura me Të*, 12 mars 2021, publik, para. 19-20; KSC-BC-2020-04, F00024, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Parë mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Parashtrime*, 20 prill 2023, publik, para. 21. Shih gjithashtu pikën 7 në Shtojcën e këtij urdhri për caktimin e datës.

temave në diskutim, konferenca mbi ecurinë e çështjes: (i) mund të mbahet në praninë e të akuzuarit dhe me pjesëmarrjen e mbrojtësit nëpërmjet videokonferencës; (ii) mund të mbahet në praninë e mbrojtësit dhe me pjesëmarrjen e të akuzuarit nëpërmjet videokonferencës; ose (iii) mund të mbahet në mungesë të të akuzuarit dhe me praninë e mbrojtësit ose pjesëmarrjes së mbrojtësit nëpërmjet videokonferencës. Gjithsesi, për këto masa nevojitet dhënia e pëlqimit me shkrim nga i akuzuari, pas këshillimit me mbrojtësin e vet, në pajtim me rregullën 96(2) të Rregullores.

24. Nëse Mbrojtësit dëshirojnë të marrin pjesë në konferencën mbi ecurinë e çështjes nëpërmjet videokonferencës, ata duhet t'i përmbushin kriteret e rregullës 96(2) të Rregullores dhe të Udhëzuesit të Punës për Videolidhjet të Administratores (KSC-BD-23/COR), paraprakisht e në kohë të mjaftueshme, në mënyrë që Administratorja të ndërmarrë hapat e duhur, përfshirë informimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake.

IV. VENDIM

25. Për arsyet e lartpërmendura,, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **VENDOS** të mbajë konferencën mbi ecurinë e çështjes në prani të ZPS-së dhe Mbrojtjes, në përputhje me paragrafin 19 më lart, të **enjten, 12 tetor 2023, në orën 14:00**; dhe
- b. **KËRKON** nga ZPS-ja dhe Mbrojtja të dorëzojnë parashtime me shkrim për: (i) cilëndo pikë të përmendur në agjendën e konferencës mbi ecurinë e çështjes të bashkëngjitur këtij urdhri; (ii) sistemin e redaktimit që duhet të zbatohet në procesin aktual; dhe/ose (iii) tema të tjera relevante që gjykohen të nevojshme, deri të **mërkurën, 11 tetor 2023, në orën 12:00**.

_____/nënshkrimi/____

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatës i Procedurës Paraprake

E hënë, 9 tetor 2023

Në Hagë, Holandë.